



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr.\_\_\_\_Prot.

Tiranë, më \_\_.06.2021

**MBLEDHJA Nr. 34,  
datë 30.06.2021, ora 11:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 30.06.2021, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 34 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar
2. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar
3. Mbi modifikimin e licencës nr. 436, seria TGN19, për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për zgjatjen e periudhës kohore, të parashikuar në pikën 3, të vendimit nr.89, datë 31.03.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 Prill 2021”
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”
6. Mbi rishikimin e programit të transparencës dhe rregjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të ERE-s

7. Informacion për monitorimin e kryer pranë qendrave të kujdesit të klientit (KNK) të shoqërisë FSHU sh.a. me qëllim të performancës të punonjësve sa i përket njohurive mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të licencuar FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. dhe adresimit të saktë të kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike
8. Informacion mbi monitorimin e realizuar në FTL sh.a. në zbatim të urdhërit nr. 33, datë 21.04.2021
9. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**